

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Janar, 2022*

SBASHK vazhdon me takimet konsultative lidhur me situatën në arsim
**Kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve
 marrin vendime konkrete**



Me qëllim që të analizojnë situatën aktuale në arsim dhe të marrin vendime konkrete në përballje me sfidat e kohës SBASHK po vazhdon takimet konsultative me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve. Kështu ishte edhe në takimin e radhës që është mbajtur në sallën e takimeve në Qendrën e studentëve. Në fillim të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj duke informuar për aktivitetet dhe angazhimet ka treguar edhe për rrjedhën e takimit me Ministren Nagavci dhe për çështjet ...(faqe 4)

Takim me shefin e Grupit
 Parlamentar të LDK-së, z.
 Arben Gashi

**Kërkohet mbështetje në
 Parlament për kërkesat e
 punëtorëve arsimorë**

Me qëllim që kërkesat
 legjitime të punëtorëve të
 arsimit të prezantuar nga
 SBASHK të gjejnë ...(faqe 6)

*Intervistë me koordinatoren
 për organizim të brendshëm
 Ymer Ymeri*

**Me unitet e përkushtim do
 të përballemi suksesshëm
 me sfidat e kohës**



Detyrë jo e lehtë është që të
 koordinohen ...(faqe 3)

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takun me ministren Nagavci

U bashkëbisedua për çështje me rëndësi



Stafi qendror i SBASHK-ut përcjell ...(faqe 5)

SBASHK ditët e vikendit në ditë të aktiviteteve të
 rëndësishme

**Dëshmohen arritjet në "Aplikimi i programeve
 kompjuterike në mësimdhënie"**



Njëri nga aktivitetet e organizuara ...(faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
 The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Të vazhdojmë bashkë e në SBASHK



Të nderuar punëtorë të arsimit, kolege e kolegë, falë angazhimit e gatishmërisë suaj periudha e dytë e procesit mësimor filloi me sukses.

Beteja për dije të reja po vështirësohet nga një valë e re e pandemisë, por ju jeni dëshmuar edhe në të kaluarën për angazhimet sublime në realizimin e misionit të shenjtë për edukimin e brezave dhe prandaj meritoni respekt të lartë e meritë. Gatishmëria dhe vullneti juaj në misionin e shenjtë të edukimit e arsimimit të

brezave na bën të ndjehemi krenar dhe Ju premtojmë se ne do të vazhdojmë ta ruajmë besimin tuaj duke u angazhuar tani e gjithmonë që të jemi zë i juaji dhe të realizojmë kërkesat tuaja legjitime.

Këto ditët në vijim janë vendimtare për fatin e Ligjit të pagave dhe prandaj duhet ta shtojmë edhe më angazhimin me qëllim që të përgatitemi në përballje me sfidat e kohës dhe të veprojmë, si gjithmonë, me unitet për realizimin e kërkesave tona lidhur me këtë ligj. Të urojmë që Qeveria ta kryej detyrën si duhet dhe të përfill kërkesat tona legjitime se në të kundërtën ne do të veprojmë e do të përgjigjemi bazuar në zërin e anëtarësisë. Të vazhdojmë bashkë e në SBASHK.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Me unitet e përkushtim do të përballemi suksesshëm me sfidat e kohës



Është fillimi i vitit 2021. Janari për SBASHK-un solli sfida të reja. Falë përkushtimit e unitetit dhe reflektimit të institucioneve u arrit të ketë marrëveshje për dy kërkesat e anëtarësisë. Tani në një situatë më të qetë

po punohet për të bërë një plan të veprimit dhe për të vazhduar me angazhimet. Për këto na flet kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj.

Arsimimi sot:

Keni pasur shumë sfida, angazhime e aktivitete .Si e vlerësoni vitin 2021 ?

Ymeri:

Vite me radhë SBASHK është duke realizuar në tërësi planifikimet dhe objektivat e përcaktuara në shërbim të anëtarësisë. Kjo po arrihet falë përkushtimit të stafit qendror, koordinimit me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve dhe mbështetjes nga anëtarësia, që na jep vullnet për të qëndruar në përballje me sfidat e kohës. Kështu ishte edhe në vitin 2021. Me angazhime të përbashkëta kemi arritur të realizojmë gjithë objektivat e planifikimet që kemi bërë në shërbim të anëtarësisë.

Arsimimi sot

SBASHK bëri shumë angazhime edhe për realizimin planit të trajnimeve.

Ymeri:

Po, është e vërtetë. Punëtorëve të arsimit u kërkoheshin numër i caktuar i orëve të trajnimeve të

licencuara për të marrë licencën e punës dhe orë të tjera trajnimesh për të pasur mundësinë për t'u bërë pjesë e procesit të gradimeve. Duke e parë se institucionet gjegjëse nuk po e kryenin këtë obligim, ishte SBASHK që edhe në këtë aspekt u doli në përkrahje anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Me cilat aktivitete tjera ndjeheni krenar ?

Ymeri:

Janë shumë, por do të veçoja aktivitetet kushtuar ditës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe e pastaj edhe aktivitetin tani më tradicional për pushimet e organizuara për një numër të konsideruar të anëtarëve tanë nga e tërë Kosova. Këto dy aktivitete organizohen me zell e përkushtim dhe realizohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne marrim përgjegjësi nga anëtarësia, por edhe nga opinioni i gjerë dhe prandaj edhe ndjehemi krenar. Kështu do të vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Arsimimi sot:

Po në vitin 2022 ?

Ymeri:

Urojmë që të kemi një situatë sa më të qetë me Covid dhe që procesi mësimor të zhvillohet në institucione arsimore. Uroj të kemi dialog të sinqertë me institucionet dhe të realizohen kërkesat legjitime të anëtarësisë se në të kundërtën do i përgjigjemi zërit të anëtarësisë dhe do të veprojmë duke respektuar vullnetin e tyre. Në fillim të prillit është Kongresi i SBSHK-ut dhe ty besoj edhe do të vendoset për kahjet e aktivitetit sindikal në të ardhmen. Jemi krenar se kemi realizuar në përpikëri objektivat dhe detyrat në shërbim të anëtarësisë dhe kjo ka bërë që radhët në SBASHK të shtohen vazhdimisht. Kështu do të vazhdojmë edhe tani tutje.

Gjatë muajit

SBASHK vazhdon me takimet konsultative lidhur me situatën në arsim

Kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve marrin vendime konkrete

Me qëllim që të analizojnë situatën aktuale në arsim dhe të marrin vendime konkrete në përballje me sfidat e kohës SBASHK po vazhdon takimet konsultative me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve. Kështu ishte edhe në takimin e radhës që është mbajtur në sallën e takimeve në Qendrën e studentëve. Në fillim të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj duke informuar për aktivitetet dhe angazhimet ka treguar edhe për rrjedhën e takimit me Ministren Nagavci dhe për çështjet e ngritura në bashkëbisedën me Ministren. Ai ka veçuar problemin e ngritur lidhur me punëtorët arsimorë që punojnë, por që janë jashtë listave të pagave në Fushë Kosovë, Mitrovicë, por edhe në komunat tjera.



‘‘Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përsëritur se ishin dhe janë kundër testimit me shkrim të njohurive të mësimdhënësve sepse është veprim nënçmues, por insistojnë në vlerësimin e performancës përmes inspektorëve profesionalë. Edhe në këtë takim kemi biseduar për Ligjin e pagave dhe kemi kërkuar që Ministria si pjesë e Kabinetit qeveritar të kontribuon që mësimdhënësit në tërësi të jenë në vend merit, por mësuesit 1-5 të barazohen me kolegët e tyre të mësimi lëndor në shkollën e mesme të ulët dhe që pedagogët, psikologët e zyrtarët të administratës në Arsimin Parauniversitar dhe në Universitete të kenë vend merit në këtë ligj. Është ngritur edhe çështja e punëtorëve arsimor me sëmundje të rënda duke

kërkuar që kjo të ngritet në Qeveri sepse SBASHK-u konsideron se është obligim moral dhe njerëzor i Qeverisë që të gjej zgjidhje meritore për ta’’, ka raportuar kryetari Jasharaj.



Pas kësaj është bërë analiza e përfundimit të zgjedhjeve të brendshme në SBASHK duke u vlerësuar nga gjithë të pranishmit se zgjedhjet kanë pasur rrjedhë të mbarë që nga shoqatat sindikale, në nivel komunash e universitetesh e pastaj edhe te Kuvendet e niveleve arsimore.


Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymer ka bërë një vlerësim të këtij aktiviteti e pastaj ka shtuar se do të vazhdohet edhe me trajnimet e licencuara. Pas kësaj janë dhënë sqarime edhe lidhur me vizitat e mundshme të inspektorëve të punës dhe është vendosur që nga ata të kërkohen me shkrim e përmes adresave elektronike se çfarë po kërkohet dhe që të orientohen në zyret e SBASHK-ut.

Një pjesë e debatit është zhvilluar edhe për aktualitetin në arsim e për ligjin e pagave dhe kërkesat tjera të anëtarësisë dhe është vendosur që të merren nga kryetarët angazhime konkrete dhe që të bashkëbisedohet me anëtarësinë se çfarë dhe si do të veprohet në lidhje me angazhimet për ligjin e pagave duke bërë përgatitje me kohë edhe për veprime konkrete sindikale nëse Qeveria nuk përfillë kërkesat konkrete të SBASHK-ut e që janë të bërë publike me kohë lidhur me Ligjin e pagave.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takun me ministren Nagavci

U bashkëbisedua për çështje me rëndësi

Stafi qendror i SBASHK-ut përcjell me vëmendje situatën në arsim dhe me kujdes analizon kërkesat dhe shqetësimet e anëtarësisë për t'i adresuar ato në Ministrinë e arsimit apo te institucionet tjera qendrore e lokale. Në kuadër të këtij angazhimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë zhvilluar takimin e radhës me ministren e MASHTI znj. Arbërie Nagavci dhe kanë diskutuar për çështje të rëndësishme në arsimin e Kosovës.



Njëri nga shqetësimet që kanë ngritur përfaqësuesit e SBASHK-ut, duke kërkuar nga Ministria Nagavci që të angazhohet brenda kompetencave të saj dhe në kuadër të qeverisë për ta

zgjidhur drejt këtë çështje, ishte edhe ajo se në komunën e Fushë Kosovës janë 53 punëtorë arsimor që punojnë por nuk marrin paga, në Mitrovicë rreth 80 raste të tilla e aty e këtu edhe në komunat e tjera ka raste që punëtorët arsimor janë duke punuar tani e ca muaj por nuk marrin paga.

Në vazhdim të këtij takimi përfaqësuesit e SBASHK-ut edhe një herë kanë kujtuar Ministren Nagavci për

çështjet që lidhen me ligjin e ri të pagave duke kërkuar mbështetjen e saj dhe angazhimin që bashkërisht të realizohet kërkesa e SBASHK-ut që punëtorët arsimorë që nga çerdhet e deri në universitete të radhiten në vend meritore në këtë ligj dhe që mos të ketë dallime në koeficiente në mes të punëtorëve arsimor në arsimin fillor e atë të mesëm të ultë. Përfaqësuesit e SBASHK-ut edhe në këtë takim janë ndalur te çështja e punëtorëve me sëmundje të rënda dhe SBASHK-u kërkoi nga ministria Nagavci që edhe kjo çështje të ngritet në nivel të qeverisë për të gjetur zgjidhje të pranueshme. Në pyetjen e ngritur nga SBASHK lidhur me kolegët e punësuar që kanë 180 kredi Ministria Nagavci është shprehur se çështja e tyre ka gjetur zgjidhje.

Ministria Nagavci theksoi se e ndanë shqetësimin me SBASHK-un lidhur me punëtorët arsimorë që janë duke punuar e nuk marrin paga dhe do të angazhohet për të gjetur zgjidhje të mundshme për ta në bashkëpunim me qeveritë lokale dhe Ministrinë e Financave. Të dy palët kanë biseduar edhe për çështjen e vlerësimit të performancës së mësimit dhe ishte vlerësim i përbashkët se vlerësimi i performancës duhet bërë sipas Udhëzimit Administrativ dhe përmes inspektorëve profesional.

SBASHK ditët e vikendit në ditë të aktiviteteve të rëndësishme

Dëshmohen arritjet në "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime"



Njëri nga aktivitetet e organizuara nga SBASHK, që ka zgjuar interesim të madh te anëtarësia, është organizimi bazuar në vullnetin e anëtarësisë i 8 trajnimeve të licencuara. Shtatë trajnimet kanë vazhduar të organizohen online edhe përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia falë përkushtimit të koordinatorit për organizim Ymer Ymeri, stafit qendror dhe angazhimit të kryetarëve të nivelit komunal sindikal duke shënuar arritje e suksese të larta. Rrethanat e krijuara nga pandemia kishin bërë që të mos organizohej për një kohë trajnimi "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime" sepse

duhej zhvilluar me prani fizike në institucione arsimore.



Mirëpo ky trajnim u bë e mundur të organizohet kur edhe procesi mësimor u zhvillua në institucione arsimore ngase vetë përmbajtja e këtij trajnimi dhe natyra e punës e angazhimit të trajnerëve dhe pjesëmarrësve në përpjekjet për të marrë njohuri të reja nga modulet për aplikimin e programeve kompjuterike në mësimdhënie kërkojnë qasje të vazhdueshme në mjetet e teknologjisë informative. Trajnimi "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" falë angazhimit të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafit qendror dhe koordinimit me kryetarë të nivelit komunal është organizuar suksesshëm në Drenas dhe në disa komuna të tjera të Kosovës.

Takim me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Arben Gashi

Kërkohet mbështetje në Parlament për kërkesat e punëtorëve arsimorë

Me qëllim që kërkesat legjitime të punëtorëve të arsimit të prezantuara nga SBASHK të gjejnë mbështetje nga deputetët në Parlamentin e Kosovës përfaqësuesit e SBASHK –ut janë takuar me shefat e Grupeve Parlamentare dhe i kanë informuar ata për situatën aktuale në arsim, për sfidat dhe për kërkesat e drejta e legjitime të anëtarësisë. Në kuadër të këtij angazhimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar në ambientet e Parlamentit të Kosovës me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Arben Gashi. Ata i kanë treguar z. Gashit se janë takuar edhe me shefat tjerë të subjekteve politike parlamentare për të bashkëbiseduar për situatën në

Pas përfundimit të pjesës së parë të këtij trajnimi e duke respektuar kriteret e parapara, në Gjimnazin "Skënderbeu– Gjergj Kastrioti" të Drenasit është mbajtur të dielën e 16 janarit edhe testi, që u ka dhënë mundësi pjesëmarrësve që të dëshmojnë njohuritë e arritura nga ditët e kaluara në trajnim. Këtë aktivitet e ka monitoruar koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, i shoqëruar nga kryetari i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Drenasin Ilaz Dervishaj, i cili ka shprehur falënderimin e anëtarësisë për gjithë aktivitetin dhe angazhimin e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë e pastaj u ka dëshiruar sukses dhe rezultate të duhura pjesëmarrësve në këtë aktivitetet. Këtë aktivitet e ka përcjellë nga afër edhe kryetari i BSPK-së Atdhe Hykolli, i cili ka përgëzuar pjesëmarrësit për vullnetin që edhe në ditë vikendi të angazhohen për të marrë njohuri të reja e për t'i përdorë ato në procesin mësimor me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë. Ai ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë përkushtimin e vazhdueshëm në shërbim të anëtarësisë duke shtuar se vetë fakti që edhe vikendet janë kthyer në ditë të angazhimit e aktivitetit dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të SBASHK-ut për realizimin e kërkesave dhe vullnetit të anëtarësisë. Ky aktivitet do të zhvillohet edhe në komunat tjera kudo që është kryer pjesa e parë e këtij trajnimi.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut në bashkëbisedë me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së janë deklaruar se kërkesat aktuale që kërkojnë zgjidhje janë çështja e Ligjit të pagave, Ligji për sigurimet shëndetësore dhe Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, gjegjësisht kriteri prej 15 vitesh kontributdhënese, që po ju paraqet shumë probleme të pensionuarve në sektorët tjerë, por në të ardhmen e afërt do të jetë prezent edhe të një pjesë e punëtorëve të arsimit.

Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së z. Gashi ka deklaruar se është njoftuar me shqetësimet e ngritura që ka bërë SBASHK-u në emër të anëtarësisë dhe se

do të bëj gjithë angazhimet bashkë me deputetet nga ky subjekt politik që në kuadër të debatit e angazhimeve në Parlament bashkë me subjektet tjera politike të ndihmohet zgjidhja e këtyre çështjeve. Në vazhdim të këtij takimi është biseduar për nevojën e angazhimit të përbashkët nga të gjitha palët për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim dhe për krijimin e kushteve më të mira të punës në sistemin arsimor në mënyrë që shkollat të jenë të pajisura me mjete bashkëkohore të punës dhe që mësimdhënësit të kenë mbështetjen për t'u përgatitur në vazhdimësi për të ecur në hap me kohën.

SBASHK reagon ndaj deklaratave të zëvendësministrit Pupovci

Nëse Ligji i pagave nguros pagat ekzistuese do të ketë grevë

SBASHK-u i reagon zëvendësministrit Pupovci: Nëse s'rriten pagat do të ketë grevë



Këtyre ditëve kur punëtorët arsimorë dhe nxënësit po sfidohen nga pandemia dhe po përballën me shtim të vazhdueshëm të numrit të të prekurve nga Covid ata kanë nevojë për mbështetje e fjalë entuziazmi nga MASHTI dhe nga prindërit e opinionin në tërësi me qëllim që ata të ndojnë këtë mbështetje e të vazhdojnë në misionin e tyre për arsimimin e edukimin e brezave. Mirëpo në vend të kësaj zëvendësministri Dukagjin Pupovci po kujdeset të dërgoj mesazhe stresi e që krijojnë tensione dhe mobilizim për veprime sindikale. Një mesazh i tillë erdhi nga zëvendësministri Pupovci edhe se fundi kur ai u mor me Ligjin e pagave duke deklaruar se aprovimi i këtij Ligji nuk do të thotë edhe ngritje e pagave. Ai, edhe më shumë se kjo, mundohet të krijojë friktë te të punësuarit në arsim duke deklaruar se na qenkan më

SBASHK-u reagon sërish për ligjin e pagave

30 January, 2022

1 minute read



shumë se 1000 punëtorë arsimorë që shteti po i mbanë nga mëshira në punë sepse gjoja ata qenkan të tepërt. Kjo deklarata e dytë lexohet si presion se po vazhduam ta ngremë zërin me kërkesat legjitime 1000 e më shumë punëtorë arsimorë do të hedhën në rrugë, por kjo hedhje në rrugë e njerëzve që me dekada punojnë në arsim nuk është punë që bëhet.

Deklarata e Pupovcit se Ligji i ri i pagave nuk sjell lëvizje pozitive në paga urojmë të jetë vetëm deklarim i tij, në të kundërtën, nëse vërtetë grupi punues i Ministrit Sfeçla dhe Qeveria Kurti po përgatitin një ligj të tillë që nguros pagat ekzistuese pa bërë lëvizjet e duhura pozitive në to, atëherë këtë farë ligji le ta mbajnë për veti. SBASHK –u do të angazhohet që

përmes përfaqësuesit të vet në takimet me grupin punues me dialog të arrij të prezantoj propozimet konkrete dhe që ato të përfillen e të jenë në versionin final të këtij ligji. Nëse kjo nuk përfilllet, atëherë Ministre Nagavci, ky nuk është as shantazh e as

kërcenim, por alarm e paralajmërim me kohë se SBASHK do ta respektojë zërin dhe vullnetin e anëtarësisë dhe se do të kemi veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme në tërë sistemin arsimor.

Në përmbyllje të agjendës së zgjedhjeve të brendshme në SBASHK

Kuvend zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Vushtrri

Me Kuvendin zgjedhor të Arsimit Parauniversitar të Vushtrri është përmbyllur viti zgjedhor në SBASHK. Këtë takim zgjedhor e ka hapur kryetari Alush Maloku, cili fillimisht ka përshëndetur të pranishmit e pastaj ka falënderuar kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri për pjesëmarrje në këtë Kuvend zgjedhor. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka përgëzuar kryetarët e shoqatave sindikale dhe gjithë koleget e kolegët në Vushtrri për përkushtimin në misionin e shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave dhe për unitetin sindikal, kurse koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime lidhur me ecurinë e zgjedhjeve duke u bazuar në kërkesat e qarta të Statutit të SBASHK-ut. Pas kësaj kryetari Maloku ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar për periudhën e kaluar, të cilat janë aprovuar nga pjesëmarrësit e këtij takimi.



Në pjesën e dytë të punimeve të këtij Kuvendi është filluar me procesin e zgjedhjeve. Komisioni zgjedhor fillimisht ka shënuar kandidaturat e pastaj është nisur procesi zgjedhor përmes votës së fshehtë e në garën mes dy e më shumë kandidatëve për kryetar,

nënkryetar, anëtarë kryesie, delegatë të Kongresit dhe përfaqësues në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut nga kjo komunë.

Me votën e lirë ky Kuvend vendosi që kryetar i ri të zgjidhet Visar Sadriu, ndërsa nënkryetare Albulena Pllana. Janë zgjedhur edhe anëtarët e kryesisë, delegatët për Kongres dhe përfaqësuesit nga kjo komunë në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Kryetari i deri tashëm Alush Maloku ka përgëzuar kryetarin e ri dhe është shprehur se do të vazhdojë të jetë i përkushtuar edhe në të ardhmen në gjithë angazhimet sindikale duke e përkrahur, ndihmuar e këshilluar kryetarin e ri. Kryetari i ri Visar Sadriu ka falënderuar pjesëmarrësit për besimin dhe është shprehur se do të angazhohet bashkë me kryesinë në shërbim të anëtarësisë duke qenë i sigurt se do ta ketë vazhdimisht përkrahjen dhe mbështetjen e stafit qendror të SBASHK-ut.

Edhe ky Kuvend duke vlerësuar lart angazhimin dhe përkushtimin e kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka dhënë mbështetjen që Jasharaj të zgjidhet edhe për një mandat kryetar i SBASHK-ut.

SBASHK iu drejtua anëtarësisë me një apel

Bashkërisht të bëjmë ndryshimet e duhura statutare

Me qëllim që Statuti i SBASHK-ut të jetë sa më përmbajtjesor dhe të ofroj përgjigje për të gjitha

çështjet e organizimit dhe aktivitetit sindikal, stafi qendror i SBASHK-ut i është drejtuar anëtarësisë që



-STATUTI I SBASHK-ut



STATUTI I SINDIKATËS SË BASHKUAR TË ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS SË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

edhe ata të kyçen për të dhënë ide konkrete për ndryshimet statutare që do të përgatitën dhe do të aprovoreshin në Kongres. Në këtë apel thuhet:

“Të nderuar kryetarë të Kuvendeve të Sindikatës të nivelit komunal e të Universiteteve, të nderuar kryetarë të shoqatave dhe Ju anëtarë të nderuar po afrohet data e mbajtjes së Kongresit dhe prandaj njëra nga çështjet me rëndësi është debati dhe kontributi Juaj për ndryshimet në Statutin e SBASHK-ut me qëllim që ai të jetë sa më përmbajtësor dhe të jep përgjigje të qarta në të gjitha çështjet e aktivitetit sindikal.

Presim angazhimin dhe kontributin tuaj duke dhënë propozime konkrete, të cilat do të adresohen në SBASHK deri më 13 shkurt përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Statutin aktual e keni të botuar në ueb faqen tonë: http://sbashk-rks.org/STATUTI_2018.pdf.

Propozimet e arritura deri më 13 shkurt do të merren në shqyrtim nga Komisioni Statutar i SBASHK-ut dhe pastaj ata do të dalin para Kongresit me propozimet e arsyeshme e që kontribuojnë që Statuti të jetë edhe më i plotë e më përmbajtësor.

Doli nga shtypi gazeta vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2021” **Pasqyrim i ngjarjeve të shumta gjatë një viti plot sfida**



Me qëllim që të mbesin si kujtesë e angazhimeve, sfidave dhe arritjeve stafi qendror ka bërë një punë të përkushtuar dhe ka arritur ta përgatis për shtyp gazetën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2021”, e cila do të jetë dhuratë për lexuesit tanë kudo në Kosovë.

Në gazetën vjetore janë sjellë shkrime për ngjarjet, angazhimet, sfidat dhe aktivitetet e shumta të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë duke filluar nga organizimi i të tetë trajnimeve me përfshirjen e më shumë se 5000 anëtarëve tanë nga e tërë Kosova, pastaj takimet e shumta konsultative, rrjedhën e zgjedhjeve të brendshme, përfaqësimi i SBASHK-ut në takime të shumta në nivel vendi, por edhe në aktivitetet e shumta sindikale ndërkombëtare.

Në gazetën vjetore, SBASHK ka lartësuar kujtimin për koleget dhe kolegët tanë që kaluan në amshim e që i përjetshëm do të jetë kujtimi për ta.

Gazeta do të jetë dhuratë për shoqatat sindikale. Lexojeni me kujdes e ne ju kërkojmë falje nëse na ka ikur pa e vërejtur ndonjë gabim në drejtshkrim.

